



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:269835
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06174673

C-IV-14-2700

Parashtruesi i kërkesës

B S fshati Gj, Komuna e Suharekës

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH “NBI Suhareka” në likuidim), Rr. ‘Dritan Hoxha’ nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 18 shtator 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- 2. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ006-0822 datë 10 mars 2014.**
- 3. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 11 prill 2014, ankuesi pranë DHPGJS, parashtror kërkesë, të emërtuar padi, për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRZ006-0822 datë 10 mars 2014, me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e diferencës së pagave në shumë prej 1,950.30 (një nëntë pesë zero tre zero) Euro, ndaj NSH “NBI Suhareka” (në likuidim).

Ankuesi, pretendon të drejtën e tij në kompensim duke ju referuar Aktgjykimit, sipas ankuesit të plotëfuqishëm, të Gjykatës Komunale në Suharekë (tani degë e gjykatës themelore Prizren), C.nr. 21/05 datë 28 prill 2005 (në tekstin në vijim AKTGJYKIMI), me të cilin i është njohur e drejta e kthimit në punë por organet e NSH këtë vendim nuk e kanë respektuar dhe në ndërkohë NSH është privatizuar.

Andaj nga të gjitha arsyet ankuesi pretendon se NSH nuk ka përmbushur obligimin, duke ju referuar sipas AKTGJYKIMIT.

Nga gjitha arsyet si më lartë dhe pasi që, ankuesi, konsideron se ka plotësuar kushtet mbi kompensimin e kërkuar, duke ju referuar AKTGJYKIM, i njëjti kërkon nga gjykata që kërkesa

e tij të aprovohet duke përfshirë edhe kërkesën për kompensimin e shpenzimeve në shumë prej 150.00 (një pesë zero) Euro.

Kërkesës për rishikim-ankesës i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL, dhe
- Kopja e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr. 432/2003 datë 3 maj 2004, me të cilin sipas këtij Aktgjykimi është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr. 58/2003 datë 2 tetor 2003, e me të cilin ankuesit i njihet e drejta në kthimin në vendin e tij të punës si dhe është anuluar vendimi nr. 67 datë 11 mars 2003.

Ankuesi me parashtrësën e parashtruar pranë DHPGJS me 27 maj 2016, parashtron kopjen e Vendimit të AL si dhe kopjen e Aktgjykimit të DHPGJS, AC-I-13-00204 datë 31 mars 2016.

Ankuesi me kërkesën e tij për rishikim nuk e ka parashtruar kopjen e AKTGJYKIMIT C.nr. 21/05 datë 28 prill 2005, sipas të cilit e mbështet kërkesën e tij për kompensim.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 17 janar 2022 parashtron përgjigjen.

AKP kundërshton ankesën si të pabazuar. Fillimisht AKP pohon se AL ka bërë një vlerësim të saktë dhe se dispozitat ligjore i ka zbatuar në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se kërkesa për rishikim si dhe nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP përfundimisht pohon se kërkesa e ankuesit konsiderohet e parashkruar, pasi që kërkesa rrjedh nga marrëdhënia e punës dhe se i njëjti nuk i është përmbajtur afatit 3 vjeçar. Nga gjitha arsyet propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigje i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL, dhe
- Kopja e Vendimit për emërimin e anëtarëve të AL.

Duke u bazuar në urdhrin e gjykatës ankuesi me datë 26 janar 2022 parashtron përgjigjen në përgjigjen e AKP.

Ankuesi mbeti në tërësi si në kërkesën e tij për rishikim, e emërtuar padi, kundërshton pretendimet e AKP mbi parashkrimin dhe përfundimisht propozoj që kërkesa e tij të aprovohet.

AKP, duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, me 8 shkurt 2022 parashtron kundër-përgjigjen.

AKP mbeti në tërësi si pranë përgjigjes.

Me 19 gusht 2024, gjykata i drejtohet me kërkesë Gjykatës themelore në Prizren – Dega në Suharekë, me të cilën kërkoj që të konfirmohet nëse Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr. 58/2003 datë 2 tetor 2003 është autentik dhe se nëse ka ndonjë Aktvendim apo Aktgjykim tjetër e i cili referohet çështjes së ankuesit.

Gjykata themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në përgjigjen e saj të parashtruar pranë DHPGJS me 16 shtator 2024, parashtron kopjet e vërtetuara të aktgjykimeve – aktvendimeve si në vijim:

- Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr. 58/2003 datë 2 tetor 2003,
- AKTGJYKIMIN C.nr. 21/05 datë 28 prill 2005,

- Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 179/2005, datë 21 dhjetor 2004, me të cilin janë prishur Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr. 432/2003 datë 3 maj 2004 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr. 58/2003 datë 2 tetor 2003,
- Aktvendimit i Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr. 217/2005 datë 31 mars 2006 me të cilin është prishur AKTGJYKIMI C.nr. 21/05 datë 28 prill 2005, dhe
- Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr. 108/06 datë 9 shtator 2008, me të cilin është ndërprerë procedura gjyqësore e inicuar nga ankuesi kundër të paditurës, NSH.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesa për rishikim -ankesa konsiderohet e pa-bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi DHPGJS (ligji nr.06/L-086), në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi kërkesën, të drejtën, e tij mbi kompensimin e pagave e mbështet ekskluzivisht në AKTGJYKIMIN (21/05 datë 28 prill 2005), me të cilin e mbështet kërkesën e tij mbi kompensimin e pagave të mbetura në shumë prej 1,950.30 (një nëntë pesë zero tre zero) Euro,.

Ashtu siç është përshkruar edhe në pjesën e rrethanave faktike të këtij aktgjykimi, AKTGJYKIMI mbi bazën e të cilit mbështetet kërkesa e ankuesit mbi kompensimin e të ardhurave personale në shumën e kërkuar është jo-ekzistent me vetë faktin se i njëjti është prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr. 217/2005 datë 31 mars 2006, e përfundimisht Gjykata Komunale në Suharekë procedurën gjyqësore lidhur padinë në këtë rast të ankuesit e ka ndërprerë, sipas Aktvendimit C.nr. 108/06 datë 9 shtator 2008.

Gjykata nuk mund të konsideroj ndryshe përveç faktit se ankuesi, me rastin e referimit sipas AKTGJYKIMIT, mbi të cilën e mbështet kërkesën e tij, si pranë AL ashtu edhe pranë kësaj gjykate, ka tentuar që këtë gjykatë ta vejë në lajthim ashtu që të tentoj të argumentoj pohimet dhe kërkesën e tij, si të gjykuar (*res judicata*), duke u bazuar kinse ashtu siç edhe pretendon në një AKTGJYKIM të plotëfuqishëm. Kjo për më tepër shihet se edhe nga sipas Aktvendimit C.nr. 40/04 datë 24 mars 2004, me të cilin procedurën gjyqësore lidhur padinë në këtë rast të ankuesit e ka ndërprerë.

Përfundimisht gjykata konsideron se në rastin konkret ankuesi kërkesa ankuesit konsiderohet se nuk i ka plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Lidhur me pretendimet e ankuesit, duke ju Aktgjykimit të DHPGJS, AC-I-13-00204 datë 31 mars 2016, dhe të drejtës së tij në pjesëmarrjen e në pjese në 20% nga privatizimi i NSH, gjykata konsideron se kjo çështje nuk mund të ndërlihet me kërkesën për paga të pa-paguara të cilat ankuesi i kërkon në rastin konkret, për më tepër kjo me arsyetim se ankuesi kërkesën e pagave të përcaktuara e mbështet në një Aktgjykim, siç u tha edhe më lartë jo-ekzistent. Çështja e të drejtës në 20% i takon një kategorie të veçantë të drejtave të punëtorëve të NSH dhe se kjo nuk mund të ndërlihet me të drejtën në paga siç është situata në rastin konkret të ankuesit.

Nga gjitha arsyet, si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHGPJS secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar